



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 166/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Abdurrahim Haxhisefa, me vendbanim Rruga “Dervish Rozhaja”, nr.12, Komuna e Pejës, paraqitur kundër Gazmend Muhaxheri, kryetar i subjektit politik LDK, dega në Pejë, lidhur me denoncimin në Polici dhe Prokurori, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e parashtruar nga Abdurrahim Haxhisefa, me vendbanim Rruga “Dervish Rozhaja”, nr.12, Komuna e Pejës.

#### A r s y e t i m

Me datën 08.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Abdurrahim Haxhisefa, nga Peja, në të cilin thekson se ndaj tij nga ana e Gazmend Muhaxheri, kryetar i subjektit politik LDK, dega në Pejë, e është bërë denoncimi në Polici dhe Prokurori në Pejë dhe dezinformim ndaj institucionit të KQZ-KKZ-së, në Pejë dhe personalitetit të tij. Po ashtu thekson se ky dezinformim është bërë në media Koha.net, të datës 03.06.2017, gjë që ka shtuar tension në procesin zgjedhor dhe familjen e tij të gjerë. Si dëshmi për këtë ka propozuar anëtarin e KKZ-së në Pejë, Fisnik Alidemaj.

PZAP-i me datën 09.06.2017, pranoi përgjigjen e në ankesë nga koalicioni LDK-AKR, me seli në Prishtinë, në të cilën theksohet se me datën 02.06.2017, kanë pranuar listën nga KKZ-së e cila nuk është e njëjtë me listën që është dorëzuar nga Dega e LDK-së në Pejë, ku pothuajse në shumicën e vendvotimeve janë ndërruar komisionerët. Po ashtu pas informimit për veprimet e ndërmarra nga ana e KKZ-së në Pejë, dega e LDK-së ka reaguar menjëherë duke njoftuar Prokurorinë Themelore në Pejë dhe Stacionin Policor në Pejë, kanë ushtruar dy ankesa në PZAP, e po ashtu kemi dalë edhe me komunikatë publike.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar:**

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e Kryesuesit të Komisionit Zgjedhor në Komunën e Pejës, me ankesën e tij pretendon se paraqitja në Polici dhe Prokurori nga Kryetari i Komunës në Pejë për dizinformim, ka shkaktuar tension në procesin zgjedhor dhe në familje e tij. Mëtutje ka pretenduar se, në mënyrë jo të drejtë dhe jo ligjore është bërë ndërrimi i vendeve të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve, nga ana e KKZ-së dhe KQZ-së. në Pejë.

Paneli, vlerëson se ankesa e parashtruar është e pa bazuar ngase parashtruesi i ankesës, pretendimet ankimore nuk i ka mbështetur me asnjë provë materiale, e cila do ti vërtetonte pretendimet e tij, andaj, PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 166/2017 më datën 09.06.2017



**Kryesuesi i Panelit**

**Rafet Haxhaj**

### ***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*